



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 3 dhe 4 Udhëzimit administrativ nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i dates 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 24.03.2026 pas shqyrtimit të propozim Vendimit mori këtë::

## V E N D I M

### PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI-KKSB

#### Neni 1

Me këtë Vendim themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi i Komunës së Lipjanit, (në vazhdim të tekstit KKSB), në përbërje si vijon:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës –Kryesues i KKSB-së
2. Brahim Shatrolli, Komandant i Stacionit Policor,
3. Zaim Baftiu, Bashkësia Islame
4. \_\_\_\_\_, Kisha ortodokse
5. Don Matej Palic, Kisha katolike
6. Afrim Mena, komuniteti shqiptar
7. Igor Cepkenovic, komuniteti serb
8. Fehmi Bikliqi, komuniteti turk
9. Erxhan Kryeziu, komuniteti ashkali
10. Fenad Mustafa, komuniteti, rom
11. Vekosllav Tomic, komuniteti kroat
12. Alush Bikliqi, Kryesuesi i komitetit për komunitete
13. \_\_\_\_\_, Zyra për barazi gjinore
14. Rasim Hasani, Drejtori i Drejtoratit për Arsim
15. Faton Mejzinolli, Kryetar i Këshillit të prindërve
16. Bleon Qazimi, përfaqësues nga FSK
17. Fehmi Gajtani, Këshilli Lokal për siguri publike,
18. Sadri Shamolli, Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi
19. Sead Aliu, Drejtor i Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim Sektori i emergjencave civile
20. Zoran Stanojevic, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
21. Bekim Krasniqi nga OJQ
22. Valmira Marevci nga OJQ

## Neni 2

Në rast të mungesës së Kryesuesit në ndonjë takim, takimin e kryeson Nënkryetari i Komunës me të drejta dhe përgjegjësi të plota ashtu siq i ka Kryesuesi i KKSB-së.

## Neni 3

KKSB-ja mban më së paku gjashtë (6) mbledhje në vit, tri (3) prej se cilave duhet të mbahen në gjashtë mujorin e parë të vitit kalendarik. KKSB-ja mund të mbledhet edhe më shpesh ose në bazë të nevojës të dhe kërkesave.

## Neni 4

Mandati i anëtarëve të KKSB-së është i njëjtë me atë të anëtarëve të Kuvendit Komunal.

## Neni 5

Detyrat, përgjegjësitë, mbledhjet dhe çështjet tjera që lidhen me punën e KKSB-së janë të përcaktuara me dispozitat e Udhëzimit administrativ nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

## Neni 6

Për punën e tyre anëtarët e KKSB-së kompensohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## Neni 7

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen elektronike të Komunës.

Nr. 15-020/04-13725  
Lipjan, më 24.03.2026

## KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit  
Daut Azemi



*Daut Azemi*